



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2011, pas shqyrtimit të Draft-rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë dhe duke u bazuar në nenin 12.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, neni 12 të Statutit të Komunës, si dhe në bazë të nenit 7-të të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/09 për transparencë nëpër komuna, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ipet në diskutim publik Draft-rregullorja për tatimin në pronën e paluajtshme për territorin e Komunës së Vushtrrisë, për vitin 2012.

Neni 2

Diskutimi publik fillon nga data 29.07.2011 dhe zgjatë deri më 29.08.2011.

Neni 3

Obligohet Zyra Komunale për Informim që të ndërmer masa për informim të qytetarëve lidhur me diskutimin publik, konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ për transparencën në komuna.

Neni 4

Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që si hartues dhe propozues i Draft-rregullores në fjalë të organizoj diskutim publik konform Udhëzimit Administrativ për transparencë në komuna Nr. 2008/09.

Gjithashtu DBF-ja obligohet që vërejtjet eventuale, sugjerimet apo propozimet për ndryshime t'ia prezantoj Kuvendit të Komunës me rastin e shqyrtimit të dytë të draft-rregullores në seancën e radhës së KK-së.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI



Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 si dhe nenin 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2011, mori këtë:

V E N D I M

Për transferim të mjeteve nga mbetjet e projekteve kapitale të tenderuara të DSHMS-së

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet buxhetore të tepruara të DSHMS-së nga programet buxhetore të mjeteve të lira, si vijon:

- 1) Mjete të planifikuara për projektin „Furnizim me inventar dhe paisje për QKMF-në e re” me kod ekonomik (83140). Vlera e planifikuar për këtë projekt ka qenë 74.606.00 €, vlera e kontraktimit të këtij projekti pas tenderimit ka qenë 41.499.00 €. Teprica e mjeteve në vlerë prej **33.107.00 €** të transferohen nga ky projekt në projektin me kodin ekonomik (83141) „Rëntgeni “ (Për QKMF-në e re).
- 2) Mjetet e tepruara të lira nga projekti „Instalimi i rrjetit të ujësjellësit me infrastrukturë përcjellëse në Pasomë (Sumë)” me kod ekonomik (83142). Vlera e planifikuar për këtë projekt ka qenë: 10.000.00 €. Ndërsa teprica e mjeteve prej **1.842.00€** të bartet në projektin me kod ekonomik (83141) „Rëntgeni”.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim Publik.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI

---

Në bazë të nenit 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenit 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç “ të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 8 të Rregullores nr. 37<sup>2</sup>/11, dt. 24.02.11 mbi përcaktimin e kritereve të ndarjes së subvencioneve të entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 28.07.2011, mori këtë:

V E N D I M

Neni 1

Ekrem Shabani (ish-pjesëtar i UÇK-së) i lejohen mjete financiare në shumën prej 3.000 € (tre mijë euro) nga buxheti i Komunës, fondi për transfere dhe subvencione.

Neni 2

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, do të shpenzohet për shërimin e plagëve për të lartpërmendurin (përmes operimit).

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 40.2 “c” të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 40.2 “dh” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë dhe nenit 8 të Rregullores nr. 37<sup>2</sup>/11, dt. 24.02.11 mbi përcaktimin e kritereve të ndarjes së subvencioneve entiteteve publike dhe jo publike dhe ndihmës momentale në të holla, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 28.07.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Familjes së të ndjerit Enver Zymeri nga fshati Duboc, Komuna e Vushtrrisë, pjesëtar i njësisë speciale të Policisë së Kosovës, i cili më 26.07.2011 u vra në krye të detyrës në Zubin Potok nga protestues serb, i lejohen mjete financiare në shumën prej 5.000 € (pesë mijë euro), për ndihmë momentale për shpenzime të ceremonisë së varrimit.

**Neni 2**

Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, ndahen nga fondi për transfere dhe subvencione i buxhetit të komunës, dhe duhet të paguhet në emër të Muharrem Zymerit, prind i të ndjerit Enver Zymeri.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

**Neni 4**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 11, 12 dhe 14 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 2.2 “b” dhe 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e vetë të mbajtur më 28.07.2011, mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Aprovohet kërkesa e NTP “Agri-Production” Nr. 01-7-4598, dt. 13.07.2011, për zgjatje të afatit shtesë prej 10 (dhjetë) muaj, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për finalizim të projektit për përpunimin e qumështit, në pronën e paluajtshme të Komunës e cila i është dhënë në shfrytëzim të përkohshëm me kompensim sipas vendimit të KK-së 01 Nr.617/09, dt.24.09.2009, ushtruesit të kësaj kërkesë.

**Neni 2**

Komuna e Vushtrrisë dhe NTP “Agri-Production” do të lidhin aneks-kontratë për zgjatje të afatit për finalizim të projektit, konform të cekurave në nenin 1 të këtij vendimi.

**Neni 3**

Në rast të dështimit nga ana e qiramarrësit që të finalizoj projektin, përkatësisht dështimit për lëshim në punë të fabrikës për përpunimin e qumështit brenda afatit të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi, i tërë projekti do të konsiderohet i dështuar, kontrata do të konsiderohet e pavlefshme dhe të gjitha investimet e qiramarrësit sa i përket objektit i cili i është dhënë në shfrytëzim, si dhe infrastruktura për rreth objektit, me përjashtim të makinave dhe pajisjeve tjera përcjellëse për përpunim të qumështit, mbesin në pronësi të Komunës së Vushtrrisë.

**Neni 4**

NTP “Agri-Production” obligohet që krahas detyrimeve sipas kontratës bazë t’i përmbush edhe këto kushte:

- 4.1. Në momentin e lëshuarjes në punë të fabrikës për përpunimin e qumështit, të punësoj së paku 10 (dhjetë) punëtorë.
- 4.2. Kapaciteti i përpunimit të qumështit me rastin e lëshuarjes në punë të fabrikës duhet të jetë së paku 10.000 (dhjetë mijë) litra qumësht brenda 24 orëve.

4.3. Qiramarrësi nuk do të ketë të drejtë të aplikoj në tenderin të cilin Komuna e Vushtrrisë do ta publikoj në rast se i njëjti dështon t'i përmbushë obligimet kontraktuese brenda afatit të përcaktuar në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij vendimi, obligohen Kryetari i Komunës, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi dhe Zhvillim.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Ferit Idrizi**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - VUSHTRRI**

---

Në bazë të nenit 17 “h” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, nenit 41.2 “ç” të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 28.07 2011 mori këtë:

**V E N D I M**

**Neni 1**

Me këtë vendim lejohet transferimi i nxënësve në shkollat si vijon:

- 1.1 Nxënësit e paraleles së ndarë në Beçuk transferohen në shkollën në Stroc.
- 1.2 Nxënësit e paraleles së ndarë në Karaçë transferohen në shkollën “A.Z. Çajupi” në Vushtrri.
- 1.3 Nxënësit e paraleles së ndarë në Studime të Epërme transferohen shkollën në Studime të Poshtme.

**Neni 2**

Transferimi i nxënësve sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të numrit të vogël të nxënësve dhe mbajtjes së mësimit jo cilësor në klasa të kombinuara.

**Neni 3**

Obligohet Drejtoria për Arsim që të siguroi transportin e rregullt të nxënësve për shkollat e cekura në nenin 1.

**Neni 4**

Obligohet Drejtoria për Arsim që punëtorët e shkollave të cekura në nenin 1 ti sistemoi në shkolla tjera, konform legjislacionit të zbatueshëm.

**Neni 5**

Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Prokurim.

**Neni 6**

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit

Ferit Idrizi



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS, VUSHTRRI**

---

Bazuar në nenin 12.2 “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 41 “d” të Statutit të Komunës, si dhe duke u bazuar në propozimin e kryesuesit të kuvendit, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më 18.07.2011 miraton këtë:

**D E K L A R A T Ë**

1. Kuvendi i Komunës në Vushtrri e mbështetë vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për ndërmarrjen e veprimeve për shtrirjen e sovranitetit në pjesën veriore të Mitrovicës.
  
2. Kuvendi i Komunës konsideron se vendimi për dërgimin e njëjësive Speciale të Policisë së Kosovës, është i drejtë, dhe plotësisht i ligjshëm, andaj kuvendi i mbështet përpjekjet për instalimin e autoritetit në atë pjesë të vendit.
  
3. Kuvendi i Komunës në Vushtrri e përkrah qëndrimin e kryeministrit të Republikës së Kosovës për vendosjen e rendit dhe ligjit në atë pjesë të vendit, si dhe inkurajon përpjekjet e Qeverisë, për të vazhduar deri në fund në vendosjen e ligjshmërisë dhe rregullit në këtë pjesë të Kosovës.
  
4. Deklarata iu dërgohet mjeteve të informimit publik.

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Ferit Idrizi**